

Udhëzim

mbi politikat

ÇKA

QËNDRON

NË

UDHËKRYQ(ET)?

PABARAZITË NË NDËRLIDHJET E MBROJTJES SOCIALE NË MAQEDONI

- PIKËPAMJA E SHFRYTËZUESIT -

Ky udhëzim mbi politikat përmbledh politikën lidhur me gjetjet nga projekti i hulumtimit "(pa)barazia në mbrojtjen sociale. Analiza shumë-nivelëshe e ndërlidhjes në dhënie dhe ndihmës sociale – Studim krahasues». Projekti i hulumtimit u zbatua në periudhën gusht të vitit 2014 – korrik të vitit 2015, nga Instituti i Politikave Evropiane - Shkup, Maqedoni, dhe Qendra për Hulumtime Shoqërore - Analitika, Bosnje e Hercegovinë.



Përmbajtja

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	2
Mbrojtja sociale si funksioni kryesor i shtetit (sidomos) në kushte të keqësuar ekonomike.....	4
Pse qasja e bazuar mbi ndërlidhjen në krijimin e politikave?	6
Pikëpamja e shfrytëzuesve: nevojat elementare, strategjitë e përballimit dhe barrierat për plotësimin e tyre	8
1. Ndihma e pamjaftueshme dhe me vonësë	
2. Llogaritë e shërbimeve komunale dhe llogaritë tjera	
3. Lejimi, qasshmëria, pranueshmëria e diskutueshme dhe cilësia e institucioneve dhe shërbimeve shtetërore	
4. Pushtuese dhe ndëshkuese	
5. Diskriminimi gjatë qasjes në institucionet shtetërore	
Rekomandimet për politikën	16

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Nëse sistemi i mbrojtjes sociale do t'u përgjigjet nevojave reale të shfrytëzuesve të tij ose të atyre që duhet të bëhen shfrytëzues të tij dhe në të vërtetë do t'i nxjerr dhe do t'i mbajë larg varfërisë, atëherë duhet t'i merr parasysh përvojat e përjetuara dhe mendimet e tyre. Kjo përgjigje duhet t'i merr parasysh dallimet në përvojat e përjashtimit dhe pafavorshmërive, gjë kjo e cila shkon përtej një aksi të vetëm. Jo të gjitha gratë, ose personat me hendikep, ose personat LGBTI, ose personat nga cilido grup "tjetër", të përkufizuar sipas një tipari personal, ose statusi, nuk vuajnë të njëjtin përjashtim dhe pafavorshmëri. Me fshirjen e këtyre dallimeve që dalin nga realiteti i përvojave të përjetuara nga politikëbërja, potenciali i sistemit të mbrojtjes sociale për t'i arritur qëllimet e veta është kryesisht i dobësuar dhe dështon në përcaktimin e nevojave dhe burimeve reale të përjashtimit dhe pafavorshmërisë.

Duke patur si qëllim ta parashtrojmë pikëpamjen e shfrytëzuesit sa i përket mbrojtjes sociale, ne kemi zbatuar një hulumtim kualitativ, i cili ka vështruar përvojat e tyre¹ të përjetuara, ka identifikuar nevojat e tyre elementare dhe strategjitë e përballimit. Pastaj ne i krahasuam këto gjetje me kornizën ligjore dhe politike.

Erdhëm në përfundim se sistemi ekzistues social i mbrojtjes në Maqedoni dështon në arritjen e këtyre qëllimeve.

¹ Të intervistuarit u përzgjedhën dhe u kontaktuan nëpërmjet të një kombinimi të ndihmës nga udhëzimet e informatorëve kryesorë (OSHC-të, organizatat bamirëse), të bëra nga persona që ndajnë ose dinë për persona të tjerë të cilët mund të përputhen me fokusin e studimit.

Njohja e dukshmërisë së përvojave të përjetuara të personave në bazë të gjinisë, trupit, racës dhe klasës është në fazën e zanafilles. Ligjet dhe politikat në masë të madhe dështojnë t'i identifikojnë dhe interpretojnë ato në mënyrën në të cilën do të ecin përtej qasjes së aksit të vetëm, dhe të cilat do të përcaktojnë masat dhe veprimet specifike për të adresuar burimet potenciale të pabarazive, gjegjësisht, pikat e përjashtimit, pafavorshmërisë dhe diskriminimit.

Nevojat e shfrytëzuesve ose atyre që duhet të jenë shfrytëzues të sistemit të mbrojtjes sociale mbeten të jenë kryesisht të paplotësuara. Ekziston një pakënaqësi mbi-zotëruese nga sistemi. Dhënia e shërbimeve konsiderohet të jetë me cilësi shumë të ulët dhe kapacitetet e institucioneve dhe personave që janë përgjegjës për sigurimin e mbrojtjes sociale konsiderohen të jenë të diskutueshme. Në përgjithësi – jo vetëm që sistemi nuk arrin tek personat me nevojën më të madhe të mbrojtjes

NDËRLIDHJA

Një sistem i bashkëveprimeve midis strukturave shoqërore që krijojnë pabarazi, përfaqësime simbolike dhe konstrukcione identiteti të cilat janë të posaçme sipas kontekstit, të orientuara drejt temës dhe pandashëm të lidhura me zakonet shoqërore".

Gabriele Winker dhe Nina Degele,
"Ndërlidhja si analizë shumë-nivelëshe:
Përballimi i pabarazisë shoqërore", Ditari
Evropian i Studimeve të Grave Vol.18
Nr.1 (2011): 54.

sociale, por ai vështrohet dhe përjetohet si diskriminues, ndëshkues, i padrejtë, i korruptuar, i paqasshëm, përderisa procedurat vlerësohen si të kushtueshme, të gjata dhe të ndërlikuara dhe shërbimet sociale kryesisht ose sikur mungojnë ose janë të paqasshme.

Më të varfërit nga të intervistuarit tanë nuk kanë qasje në ushqim, banim, shëndetësi, transport dhe qasje fizike dhe ndijmore. Pasiguria e ushqimit dallohet si shqetësimi më presionues, duke ditur se shumica e të intervistuarve tanë thonë se hanë vetëm një vakt ushqimi në ditë, kryesisht të ofruar në kuzhina popullore, që do të thotë mungesë të ushqimit gjatë fundjavëve. Jetat e tyre janë betejë e përditshme për të lidhur skajin me skaj dhe për të siguruar jetesë për vete dhe për familjet e tyre. Edhe pse ndihma financiare vlerësohet si me vonesë dhe e pamjaftueshme, prapëseprap është një strategji e dëshirueshme dhe e domosdoshme për përballje për gjithë të intervistuarit tanë. Sistemi i mbrojtjes sociale gjithashtu nuk arrin ta identifikojë shumicën e nevojave tjera të rëndësishme siç janë higjiena, produktet për foshnje, pushimi dhe koha e lirë, shëndeti mendor dhe seksual e kështu me radhë. Nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe të familjeve të tyre mbeten të jenë të paplotësuara në masë të madhe, ndërsa jetat e tyre të përmbushura me stigmë dhe përjashtim.

Për t'i trajtuar këto çështje, ne po parashtrijmë një listë rekomandimesh, e cila është kompilim i rekomandimeve të përmbledhura nga vetë të intervistuarit tanë – persona që janë ose duhet të jenë shfrytëzues të sistemit të mbrojtjes sociale. Disa iu referohen çështjeve më të përgjithshme, ndërsa disa të tjerë ngrihin çështje me specifike. Rekomandimet e bëra nga ekipi jonë i hulumtimit janë të përfshirë në tekstin e vetë udhëzimit,

dhe ato shpesh përputhen me ato që janë lëshuar nga të intervistuarit tanë. Ne këtu do të nënvizojmë vetëm një rekomandim: Një proces i hapur, me pjesëmarrje dhe transparent i diskutimeve lidhur me atë se çfarë lloji i mbrojtjes sociale i nevojitet Maqedonisë dhe si kjo më së miri mund

NGA VIJNË TË DHËNAT TONA

- 33 intervista me persona që janë ose duhet të jenë shfrytëzues të sistemit të mbrojtjes sociale (janar-mars 2015)
- Grupet e fokusit me jopranues
- Analizimet e artikujve të mediave
- Rishikimi kritik i literaturës ekzistuese

të arrihet – ai duhet të hapet në nivelin kombëtar. Duhet të arrihet një konsensus politik i cili do të hapë vetë procesin dhe i cili domosdo duhet të lirohet nga keqpërdorimi politik. Në këtë proces, zërat e shfrytëzuesve ose atyre që duhet të bëhen shfrytëzues të sistemit të mbrojtjes sociale duhet të dëgjohen dhe përvojat e tyre të përjetura duhet të merren në konsideratë. Veç kësaj, rekomandojmë zbatimin e një studimi të mundësive për aplikimin e ndërlidhjes në politikëbërje, gjë kjo e cila do të përfshijë mësimet e marra nga një proces tjetër kombëtar me potencial të vlerësuar mirë për suksesin ose dështimin e transplantimeve politike.

MBROJTJA SOCIALE SI FUNKSIONI KRYESOR I SHTETIT (SIDOMOS) NË KUSHTE TË KEQËSUARA EKONOMIKE

Shkalla e papunësisë në Maqedoni është shumë e lartë, standardi i jetesës është më i ulët dhe shumica e qytetarëve të saj i janë nënshtruar lëndueshmërisë sociale. Pothuajse një e katërta e popullsisë së Maqedonisë jeton në varfëri, sipas Bankës Botërore.² Sipas burimeve tjera, shifrat arrijnë në 30.9%. Përqindja e papunësisë në vitin 2015 ishte llogaritur në 25.5%. Gratë fitojnë 12.5% më pak për punë me vlerë të barabartë, ndërsa mospërputhja po rritet me uljen e nivelit arsimor; gjegjësisht, arrin deri në 28.4% për personat pa arsimim formal, ose me arsimim fillor. Për vendet e punës me vlerë të barabartë, me të njëjtën përvojë dhe arsimim, gruaja duhet të paguhet për 17.3% më pak se burri.³ Në vitin 2014, janë regjistruar 133.539 anëtarë të amvisërive të cilët marrin ndihmë sociale në para.

Numri i madh i vendeve të mbyllura të punës në tranzicion, mungesa e vendeve të reja të punës dhe mungesa e aftësive për punësimin e personave të cilët do të ishin të përshtatshëm për kushtet e sapo vendosura të tregut, janë të lidhura me rënie të gjendjes së mirëqenies. Kjo e fundit si duket akoma po vazhdon. Është

² Banka Botërore, "Proporcioni i varfërisë sipas popullsisë së përgjithshme në suazat e varfërisë kombëtare (% e popullsisë)" <http://data.worldbank.org/indicator/SI.POV.NAHC/countries/MK?display=graph>

³ Burimi: Finance Think, EdPlako application. <http://www.ed-plako.mk/истражувања/>

"Mund ta shihni nivelin e varfërisë me mbeturinat që lënë pas."

*Ramizi, mbledhës i mbeturinave,
baba, amvisëri me 11 anëtarë*

cilësinë e shërbimeve sociale (siç janë shërbimet e shëndetësisë seksuale dhe riprodhuese, ndihma në kërkimin e punës, shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, ose për të moshuarit).

Kjo gjë mund të gjurmohet me ndjekjen e ndryshimeve në ligjet dhe nënligjet në fushën e mbrojtjes sociale. Si rezultat i kësaj, shtohen nevojat dhe rreziqet sociale, duke i thellësuar përçarjet sociale dhe kështu, duke i shtuar nevojat për mbrojtje sociale, si dhe përgjegjësitë e shtetit për ta ofruar atë. Veç kësaj, shtohet dhe pasiguria juridike, gjë kjo e cila mund të shihet si nga numri i ndryshimeve ligjvënëse të cilave i nënshtrohet një akt i vetëm gjatë vitit, si dhe në përgjithësi. Për shembull, Ligji mbi Mbrojtjen Sociale u miratua në qershor të vitit 2009 dhe deri më tani është ndryshuar shtatëmbëdhjetë herë.⁴

Pavarësisht nga konteksti, disa studime janë përqëndruar në përvojat e përjetuara të personave që jetojnë në margjinat e shoqërisë. Kjo gjë bën që mos të hetohet ndërlikueshmëria e rrethanave të tyre personale dhe të nevojave/rreziqeve të tyre, si dhe ato të mos përfshihen me ligjet dhe politikatat.

⁴ Ligji mbi Mbrojtjen Sociale, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 72/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15; Vendimi i Gjykatës Kushtetuese: 07.04.2010.

QASJA SIPAS AKSIT TË VETËM

Ligjet dhe politikat akoma kryesisht ndjekin qasjen sipas aksit të vetëm. Kjo do të thotë se ata rrëzojnë njerëzit në një tipar ose status personal të vetëm, duke mos marrë kështu në konsideratë ndërlikueshmëritë e mundshme dhe çështjet kontekstuale që dalin nga nuancat brenda tiparit ose statusit dhe ndërkaq – formojnë ndërlidhjet e tyre.

Trajtimi i tipareve ose statuseve personale sipas ligjit, si baza të mbrojtura mund të nxisë shumë debate, siç janë bazat e mbrojtjes, përse, me çfarë spektri, cili është bashkëveprimi me baza tjera, në cilat fusha, nga kush dhe më në fund, për ku janë ndërlidhjet. Gjithë këto debate patjetër duhet gjetur vendin e vet në krijimin e politikave. Rëndësia e tyre më tej rritet kur merren parasysh ato që më së miri përshkruhen si “e thjeshtësuara i përshtatet asaj që është “e natyrshme”, biologjisë [...], natyraliteti i mendimit praktik”⁵. Dallimet sociale të ndërlikuara mund të merren parasysh ose të refuzohen me një përshtatje “natyrës”, gjë kjo e cila shumë i përshtatet mendimit praktik, por nuk duhet patur hapësirë në politikëbërjen sociale pasi, ashtu si Gaine me drejtë shënon, “lehtësia ngashënjese me të cilën [natyraliteti i mendimit praktik] shpjegon dukuritë shoqërore është ajo që e bën më së shumti despotik”⁶.

Është pra ky rasti me Maqedoninë. Orientimi seksual dhe identiteti gjinor⁷ janë

5 Chris Gaine, “Konkluzioni”, në Chris Gaine dhe të tjerë (ed) *Barazia dhe Diversiteti në Praktikën e Punës Sociale* (Learning Matters Ltd, 2010), 116.

6 Ibid.

7 E kuptuar sipas Parimeve Yogyakarta: Parimet Yogyakarta. *Ueb faqja e Parimeve Yogyakarta*. <http://www.yogyakartaprinciples.org/principles_en.htm>. 18.02.2016. Shihni dhe: “Initiative Article 3 [Iniciativa, Neni 3]”, <http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2014/05/merged_document.pdf>, E qasur së fundi: 18.02.2016

përrjashtuar nga dispozitat mbi bazat e mbrojtura në ligj, duke bërë thirrje, mes tjerash, për përshtatjet e tilla të thjeshtësuara dhe natyralitetin e mendimit praktik. Parashtrimi i heteroseksualitetit si “e drejtë” “e natyrshme” dhe biologjike dhe joshje të arsyeshme ndaj gjinisë së kundërt, kjo automatikisht paraqet homoseksualët, biseksualët dhe aseksualët si jo të natyrshëm dhe që sillen në kundërshtim me biologjinë. Pasi kjo gjë më tej u theksua nga religjioni si pjesë e “natyrës”, gjendja u acarua dhe më tepër.

Minimumi i thjeshtë i mbrojtjes juridike mbi bazat e orientimit seksual dhe të identitetit gjinor duhet të sigurohet në bazë të ligjit menjëherë, dhe duhet të ndjeket me punë të mëtejshme rreth harmonizimit të ligjeve tjera dhe politikave, si dhe rreth aplikimit të masave për të rafinuar historinë e mëparshme të pabarazisë tek personat të cilët janë me orientim seksual të ndryshëm nga ai heteroseksual dhe personat me identitet gjinor që nuk përputhet. Ekzistojnë dëshmi të stërmëdha për ndryshimet politike në këtë drejtim.⁸

8 Të numërojmë disa nga ato të fundit: Dokumenti i vendit mbi të cilin bazohet ky udhëzim mbi politikën përmban dëshmi të tilla. Shihni: Biljana Kotevska dhe të tjerë, *Arti i Mbijetesës: Ndërlidhja e pabarazive në mbrojtjen sociale në Maqedoni – Rezultatet e një hulumtimi empirik* (Instituti i Politikave Evropiane – Shkup, viti 2016). Dëshmi mbi personat LGBTI nëpër etnitë në Maqedoni mund të gjenden në studimin e metodave ndërsektoriale: Kristefer Stojanovski, dhe të tjerë, “Është një vetmi, e madhe brenda meje”: Ndikimet e politikave dhe shoqërisë mbi burrat që bëjnë seks me burra dhe trans-gratë në Maqedoni” *Hulumtimi i seksualitetit dhe politikës sociale*, (2015). Raporti i fundit nga hulumtimi që përmban gjetje nga personat e anketuar LGBTI ofron informacione të detajuara mbi, mes tjerash, mbrojtjen sociale. Shihni: Koço Andonovski dhe të tjerë, *Analizimi i problemeve dhe nevojave të personave LGBTI në Republikën e Maqedonisë në fushën e mbrojtjes sociale, shërbimeve juridike dhe veprimi i politikave* (Qendra LGBT e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë, 2016). Për argumentet mbi ndryshimet ligjvënëse të ligjit, ku shtohet orientimi seksual dhe identiteti gjinor, shihni: “Initiative Article 3 [Iniciativa, Neni 3]”, <http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2014/05/merged_document.pdf>, E qasur së fundi: 18.02.2016 E njëjta gjë është në kontekstin më të gjerë, duke ftuar për harmonizim ndërkombëtar të legjislationit kombëtar mbi barazinë dhe mosdiskriminimin në vend, mund të gjendet në: Biljana Kotevska, *Analiza e harmonizimit të legjislationit kombëtar mbi barazinë dhe mosdiskriminimin* (vijon – 2016; OSBE dhe CPAD). Veç kësaj, mund t’u referoheni dhe raporteve të organizatave ndërkombëtare qeveritare, duke përfshirë këtu dhe Bashkimin Evropian.

Qasja ligjvënese ndaj pabarazive ka përparuar vetëm deri në pikën ku dispozitat mbi diskriminimin e shumëfishtë janë përfshirë në shumicën e ligjeve kombëtare mbi barazitë, por megjithatë, pa vendosur mekanizma dhe garanci për identifikimin dhe trajtimin e diskriminimit të shumëfishtë.

Duhet shënuar se vlerësimi i përgjithshëm i politikës kombëtare të mbrojtjes sociale lidhur me këtë çështje është “faza zanafillë”, pasi disa nga politikat marrin parasysh disa tipare ose statuse personale. Megjithatë, ndërlidhjet e këtyre mbeten të pasqaruara. Kështu, si vlerësimet kombëtare ashtu dhe ato ndërkombëtare kanë konstatuar se përfshirja e personave socialisht të lëndueshëm dhe/ose personave me aftësi të kufizuara në vend, nuk është përmirësuar.⁹

PSE QASJA E BAZUAR MBI NDËRLIDHJEN NË KRIJIMIN E POLITIKAVE?

Ndërlidhja pamundëson rrëzimin e njerëzve në tipare të vetme, kuptimi i saktë i përvojave të përjetuara, por dhe vendndodhjet sociale dhe kategoritë dhe si janë ndërtuar ato, siç janë gjinia, raca, klasa, aftësia, e kështu me radhë.¹⁰ Veç kësaj, ndërlidhja ndihmon identifikimin dhe mësuaren e proceseve sociale rrjedhëse dhe e strukturave ekzistuese dhe si ato formohen nën ndikimin e marrëdhënieve të fuqive.

9 Bashkimi Evropian, Raporti për Maqedoninë i vitit 2015 (10.11.2015) <http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf>. I qasur së fundi: 18.02.2016

10 Olena Hankivsky (ed) *Korniza e analizimit të politikës së bazuar mbi ndërlidhje* (Vancouver, BC: Instituti i Hulumentit të Ndërlidhshmërisë dhe Politikave, Universiteti Simon Fraser, 2012), 17.

ÇKA MUND TË BËJNË POLITIKËBËRËSIT ME NDIHMËN E NDËRLIDHJES?

- T'i bëjnë pabarazitë të dukshme dhe kategorike
- Të përfshijnë një spektër të gjerë të kategorive të shumta të pabarazive
- Të artikulojnë dinamikat midis këtyre kategorive
- Të demonstrojnë kuptim strukturor të marrëdhënieve të fuqisë ekzistuese¹¹, punimet dhe kompleksitetet e tyre
- Të shfaqin vetëdije për, dhe të sfidojnë privilegje dhe barazi, duke i përfshirë ata që janë të pranishëm në politikat dhe ligjet ekzistuese
- Të shmangin stigmatizimin e personave dhe grupeve në pikat e ndërlidhjes
- Të rrisin konsultimin dhe pjesëmarrjen e vepruesve nga shoqëria civile në krijimin e politikave¹²

11 Si ato të racizmit, seksizmit, heteronormativizmit e kështu me radhë, duke vepruar sipas mendimit të vet dhe sipas ngërthimit të sistemeve të shtypjes.

12 Lombardo dhe Agustin (2009), të përmbledhur në Olena Hankivsky (ed) *Korniza e analizimit të politikës së bazuar mbi ndërlidhje* (Vancouver, BC: Instituti i Hulumentit të Ndërlidhshmërisë dhe Politikave, Universiteti Simon Fraser, 2012),18.

SI MUND POLITIKËBËRËSIT TË APLIKOJNË NJË QASJE TË NDËRLIDHJES NË KRIJIMIN E POLITIKAVE?

1. DUKE I APLIKUAR PARIMET UDHËZUESE NË VIJIM¹³:

Udhëzues e në vijim

- Duke vepruar me kategoritë e kryqëzuara
- Duke analizuar nivelet e shumëfishta
- Duke i vënë re fuqisë së nivelit simbolik, strukturor dhe individual
- Duke futur në përdorim një praktikë të refleksitetit si pjesë e përpjekjeve për t'i njohur marrëdhëniet ekzistuese të fuqisë
- Duke e identifikuar rëndësinë e kohës dhe hapësirës për formësimin e përvojave të përjetuara
- Duke marrë nga dituritë e ndryshme nga gjithë personat që janë të prekur me politikën
- Duke synuar për drejtësi sociale, sidomos në drejtim të transformimit të mënyrës se si prodhohen resurset dhe lidhjet
- Duke konsideruar parimin e drejtësisë si ndershmëri

2. DUKE I PARASHTRUAR TË GJITHA PYETJET PËRSHKRUESE DHE TRANSFORMUESE¹⁴ NË PROCESET E KRIJIMIT TË POLITIKAVE, SI VIJON:

Përshkruese

- Çfarë diturie, vlerash dhe përvojash sjellni në këtë fushë të analizës së politikave?
- Cili është "problemi" i politikës që po shqyrtohet?
- Si është shfaqur prezantimi i "problemit"?
- Si janë prekur grupet, secili ndryshe të prekur me prezantimin e "problemit"?
- Cilat janë përgjigjet e politikës aktuale lidhur me "problemin"?

Transformuese


- Cilat pabarazi aktualisht ekzistojnë në lidhje me problemin?
- Ku dhe si mund të bëhen intervenime për ta përmirësuar problemin?
- Cilat janë zgjidhjet e zbatueshme të shkurtra, të mesme dhe afatgjate?
- Si do t'i pakësojnë pabarazitë përgjigjet e propozuara politike?
- Si do të sigurohet zbatimi dhe marrja?
- Si do ta dini nëse pabarazitë janë pakësuar?
- Si është transformuar procesi i inkadrimit në një analizë të politikës së bazuar mbi ndërlidhshmëri:
 - Mendimi juaj lidhur me lidhjet dhe strukturat e fuqisë dhe pabarazisë?
 - Mënyrat në të cilat ju dhe të tjerit po inkadrohen në punën e zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave?
 - Konceptualizimet, lidhjet dhe efektet më të gjera të asimetrisë së fuqive në botën e përditshme?

13 Siç është propozuar në: Olena Hankivsky (ed) Korniza e analizimit të politikës së bazuar mbi ndërlidhje (Vancouver, BC: Instituti i Hulumtimit të Ndërlidhshmërisë dhe Politikave, Universiteti Simon Fraser, 2012).

14 Burimi i listës së pyetjeve: Korniza e analizimit të politikës së bazuar mbi ndërlidhje (Vancouver, BC: Instituti i Hulumtimit të Ndërlidhshmërisë dhe Politikave, Universiteti Simon Fraser, 2012). Lëxuesit udhëzohen drejt punës origjinale për listën e plotë dhe të hollësishme të pyetjeve.

PIKËPAMJA E SHFRYTËZUESVE: NEVOJAT ELEMENTARE, STRATEGJITË E PËRBALLIMIT DHE BARRIERAT PËR PLOTËSIMIN E TYRE

Imazhi Nr.1 Nevojat elementare të të intervistuarve



“Nuk kemi pranuar ndihmë sociale për tanimë dy-tre muaj. Edhe atëherë kur më në fund vendosin të na dërgojnë para, ato janë në shumë për një muaj, jo për tre. Ndodh shumë shpesh. Nganjëherë gjej veten në situatë kur nuk mund të blej ilaçe për fëmion tim.”

Petra, nënë e një fëmiju me aftësi të kufizuara intelektuale

1. NDIHMA E PAMJAFTUESHME DHE ME VONESË

Gjithë të intervistuarit kanë theksuar çështjen e shumës tepër të ulët/të pamjaftueshme të ndihmës sociale financiare, ose, si tha njëri nga të intervistuarit tanë: “Mezi se mund të mbijetosh me ndihmën sociale, e të mos flasim për një jetë të denjë.” Një vështrim më i thellë në nivelin strukturor tregon se ky kritikizëm është i kualifikuar.

“Nëse çmimet rriten, atëherë duhet të rriten dhe të ardhurat, a nuk mendoni kështu?” Orhani

Domethënë, nëse nisemi nga vlera mesatare mujore e ndihmës sociale, e cila është 50 euro, dhe pastaj të marrim parasysh se rroga mesatare neto në vend është 350 euro, dhe se shporta mujore e konsumatorit për amvisëri me katër anëtarë është 500 euro, është e qartë se kjo shumë është tepër e ulët.

“Nuk mund të kërkoj ndihmë e cila do të jetë në nivel të rrogës. Por të pa-

Më duhej të përballem me përmbarues, edhe përsëri asaj se kisha dorëzuar një kërkesë që shteti të më ndihmojë t'i shlyej borxhet e mia. Me duhej të jepja 110000 denarë për ta paguar llogarinë e energjisë elektrike. Nuk kam para, si mund të paguaj?

Dragana, person me aftësi të kufizuara fizike, shfrytëzuese e ndihmës sociale, amvisëri me një anëtar

ktën 100 euro. Në fund të fundit, 6.000 denarë... Më kuptoni ku e kam fjalën, a po? Të arrijmë të paktën një nivel të sigurisë sociale...” Jadranka

Përveç se është e pamjaftueshme, ndihma sociale shpeshherë vonohet, siç mund të lexohet në fragmentin e intervistës me një nënë dhe kujdestare e një personi me aftësi të kufizuara.

2. LLOGARITË E SHËRBIMEVE KOMUNALE DHE LLOGARITË TJERA

Edhe pse shteti gjërësisht kishte publikuar një fushatë dhe politikanët janë lavdëruar se do t'ua shlyejnë shpenzimet e shërbimeve komunale personave që pranojnë ndihmë sociale (energjinë elektrike, ujin) dhe shlyerjen e borxheve të mëparshme (kreditë bankare dhe llogaritë e vonuara), është e qartë nga intervistat dhe nga raporimet e mediave se në fakt, personat ende po i pranojnë këto llogari dhe se ata në fakt nuk janë paguar nga shteti.

“[Shteti] duhet menduar rreth ngritjes së ndihmës të paktën për një shumë të vogël në muajt që vijojnë, kur ata dinë se shpenzimet tona po shtohen [domethënë, gjatë stinës së dimrit].” Jadranka

Gjithashtu, personat kanë pranuar urdhëra dhe janë ballafaquar me vizita të përmbaruesve për shkak të borxheve të papaguara, edhe pse ata kanë parashtruar kërkesa për shlyerje të borxheve nga shteti, ashtu siç mund të shihet nga

Një nënë e vetme e fëmiut me sindromin Down që jeton në zonë rurale po përballlet me pengesa për qasje në godina për përkujdesje dhe socializim të fëmiut të saj, siç janë qendrat ditore për personat me aftësi të kufizuara intelektuale. Të jetosh në një zonë rurale me transport të parregullt dhe të kushtueshëm, ajo ishte orvatur ta inkadrojë fëmiun e saj në komunitetin më të afërt, por kishte kuptuar se fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale janë më të stigmatizuar në fshatrat. Pastaj ajo ishte angazhuar për hapjen e një qendre ditore në zonën e saj. Orvatjet e saja kanë qenë të pasuksesshme. Frika e saj kryesore, siç është rasti me kujdestarët tjerë të personave me aftësi të kufizuara, është fati i fëmiut pas vdekjes së saj.

përvoja e Draganës (shihni citatin). Përskaaj stresit dhe ngarkesës administrative, kjo nënkupton dhe shpenzime plotësuese për ata.

3. LEJIMI, QASSHMËRIA, PRANUESHMËRIA E DISKUTUESHME DHE CILËSIA E INSTITUCIONEVE DHE SHËRBIMEVE SHTETËRORE

Kostoja e procedurave administrative në përgjithësi, si dhe kohëzgjatja e tyre shkaktojnë ngarkesë për shfrytëzuesit ose atyre që duhet të bëhen shfrytëzues të sistemit të mbrojtjes sociale. Duke ditur se shuma mesatare mujore e ndihmës, siç u përmend dhe më herët, është rreth 50 euro, kurse taksa më e ulët administrative për procesimin e një dokumenti është 0.9 euro cent.

“Më tepër do të paguani për dokumentet, sesa do të merreni ndihmë” - Dragana

Aq më tepër, zyrat ku mund të kryhen këto procedura zakonisht janë stacionuar në qendrat e qyteteve dhe në kryeqytet, dhe kjo do të thotë se personat që jetojnë më larg dhe ata që jetojnë në zonat rurale u janë nënshtruar plotësueshëm shpenzimeve të drejtpërdrejta – udhëtim dhe ushqim, por dhe shpenzimeve të tërthorta – përkujdesja për personat që kanë mbetur në shtëpi, humbja e ditëve të punës në ekonominë gri, problemet shëndetësore/ngarkesat plotësuese që dalin nga udhëtimi, etj.

“Shumë dokumente për pak para” - Jadranka

Procedurat administrative duket se janë plotësueshëm ngarkuese nga pikëpam-

ja e qasshmërisë ndijmore dhe fizike, por gjithashtu dhe për personat që kanë vështirësi me alfabetizmin ose personat që po përballen me barriera gjuhësore, si dhe për personat me aftësi të kufizuara psiko-sociale. Siç u shënua nga njëri nga të intervistuarit me aftësi të kufizuar fizike:

“Më duhet të shkoj në Zyrën e të Ardhurave Publike, por nuk mund të arrij atje. Janë shkallë para teje, mund t’i shohësh të gjithë si vrapojnë këndeje e andej, dhe kjo të shqetëson. Jo vetëm që të shqetëson, por kjo të vret përbrënda.” Fatmiri

“Nuk ka një zyrë të posaçme ose diçka të ngjashme për personat me aftësi të kufizuara. Duhet patur një qasje të posaçme. Dikush do të ma lirojë vendin e tij në varg, por dikush tjetër do të thotë, unë po pres tanimë gjysmë ore, pra dhe ti duhet të presësh.” Senada

“Kam qenë në një tualet publik të qasshëm për persona me aftësi të kufizuara, dhe do të kisha patur dëshirë të shoh më tepër nga ai lloj.” Jadranka

“Nuk mund lehtë t’i ngjesësh shkallët me paterica. [...] Nuk është fare e lehtë.” Drita

Shfrytëzuesit kanë raportuar nevoja plotësuese për mbështetje nga shteti të cilat kapërcejnë mbështetjen financiare. Këtu bie, siç mund të shihet më lartë nga

tabela, ndihma financiare, më së shumti e raportuar si nevojë për personat me aftësi të kufizuara, ose kujdestarët e personave/fëmijëve me aftësi të kufizuara. Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara gjithashtu kanë raportuar mungesën e shërbimeve në përgjithësi dhe mungesën e përhapjes gjeografike të qendrave ditore, si një nga barrierat kryesore. Cilësia e shërbimeve të dhëna gjithashtu është sjellur në pyetje.

“Nuk e kuptoj pse më duhet të shkoj dhe të marr dokumentin për vazhdimin e ndihmës sociale. Ata e dinë ku jetoj, e kanë adresën time. Pse thjeshtë, nuk e dërgojnë letrën në një zarf? [...] Shteti duhet të shtojë një shënim në të gjitha ato dokumente se bëhet fjalë për një person me aftësi të kufizuara, dhe se paratë duhet t’i jepen atij personi në dorë.” Jadranka

“Shteti duhet të paguajë dikë për të shkuar dhe për t’i ndihmuar familjet ku ka persona që përdorin karroca invalidësh, pasi ata nuk mund t’i bëjnë të gjitha vetë.” Sasho

“Personi mjekësor duhet qenë më i kualifikuar dhe duhet t’u ndihmojë më tepër njerëzve.” Fatmiri

Është një shkallë mbizotëruese e bren-gosjes në mesin e prindërve me fëmijë me aftësi të kufizuara për ardhmërinë e fëmijëve të tyre pasi të kenë vdekur.

“Vetëm dëshiroj të mund

ta dij se kur shoqja ime dhe unë do të vdesim, ai do të ketë ku të shkojë, se ai do të ketë një dhomë, një tualet, një vend qëndrimi (Stefani).

Një prind tjetër i vajzës me shizofreni mendohet për të nënshkruar një kontratë me dikë i cili do të kujdeset për vajzën e tij derisa ajo të vdesë, dhe ta trashëgojë shtëpinë si kompensim (Sasho). Një prind tjetër tha se ky ishte ankthi më i madh i saj, pasi e di se pas vdekjes së saj, askush nuk do të kujdeset për të birin e saj (Marina).

Ka mungesë të shërbimeve përkatëse dhe/ose reagimeve të sistemit të mbrojtjes sociale në përgjithësi kur bëhet fjalë për personat që abuzojnë alkoolin. Kjo rezulton me atë që familjet bartin gjithë ngarkesën dhe zhvillimin e strategjive të përballimit, përderisa sistemi po mbetet të jetë i painteresuar.

4. PUSHTUESE DHE NDËSHKUESE

Shfrytëzuesve të ndihmës sociale që pranojnë mjete financiare në llogaritë e tyre bankare dhe/ose me transferrime nëpërmjet të bankës (përfshirë këtu dhe dërgimet e parave) u ndërpritet ndihma sociale. Edhe pse është e qartë se ata nuk mund të jetojnë me 50 euro në muaj (shuma mesatare e ndihmës sociale), prapëseprap ndodh ndërprerja. Kjo gjë shikohet si një masë të padrejtë. Kjo ka rritur kritikizmin e sistemit si ndëshkues, pushtues dhe se nxit joaktivitet dhe pasivitet. Ashtu si tha një nënë e vetme, pranuese e ndihmës së përhershme fi-

nanciare: “sistemi më bën të ndjehem si viktimë, sikur të jem e paaftë për të bërë asgjë, edhe pse jam aktive 24/7”. Ngjashëm me këtë, një i intervistuar me aftësi të kufizuar fizike sqaroi: “Jam fizikisht i paaftë për të punuar, por unë mund të shkruaj një artikull ose një poemë dhe të fitoj ca para për të.” Të intervistuarit thonë se ndjehen të kapur në grackë, pasi nuk mund të punojnë askund për shuma të vogla siç kanë bërë më parë, pasi kjo do t’u shkaktonte humbjen e ndihmës së tyre.

“Sikur të ishim të prangosur, e kuptoni - kontrolli [...] Ju rrah dhe nuk ju lë të qani; [...] Nuk ju lejohet të jetoni, njeri, vetëm të jetoni. E kuptoni, kam këtë ndjenjë të vazhdueshme se kam një litar rreth qafës [...] dëshironi të jetoni, por dikush tërheq atë litar.” (Dragana)

Aq më tepër, nëse shteti mëson se po pranoni financa tjera, kjo jo vetëm që do t’ua ndërpresë ndihmën, por do t’u bëjë që të ktheni të gjitha paratë të cilat keni pranuar si ndihmë sociale pasi keni pranuar para nga dikush tjetër. Kjo thjeshtësohet me përvojën e jetuar të prezantuar në Katrorin Nr. 2. Veç kësaj, një e intervistuar tjetër ndau përvojën e vet se si ky monitorim dhe ndëshkim ndodh në realitet:

“[Punonjësit në shërbimet sociale] u shfaqën në një kontroll të paparalajmëruar dhe më panë si po i kaloja një palë pantallona në makinën qepëse. Ata menjëherë ndërprejnë ndihmën time pasi, gjoja po bëja para shtesë duke qepur për njerëz


tjerë. Kjo makine qepëse ishte vetëm për përdorim personal; Nuk kam qepur për njerëz tjerë!” (Jadranka).

Kjo plotësueshëm u ngarkua me aplikimin retroaktiv të këtij akti nënligjor, edhe pse hyri në fuqi më 1 janar të vitit 2015, ai po aplikohet sikur të ishte në fuqi që nga data e miratimit të tij, gjë kjo që ka ndodhur në vitin 2013. Kjo gjë rezultoi me ndërprerjen e ndihmës së shumë njerëzve, dhe aq më tepër, në gjendjen ku kërkohet nga ata t'i kthejnë paratë që kanë pranuar për pothuajse dy vjet. Çështja e pasigurisë juridike se kjo do të rritet po acarohet me ndryshimet e shpeshta të ligjeve.

5. DISKRIMINIMI GJATË QASJES NË INSTITUCIONET SHTETËRORE

Një nga format më të vërejtura të diskriminimit lidhur me veprimet e institucioneve shtetërore është mungesa e sistemimit të duhur, siç u shënuar më lartë. Është kjo një formë jashtëligjore e diskriminimit sipas ligjit të brendshëm, dhe si duket, ekziston ende në sektorin publik, si dhe në atë privat.

Një mungesë e sistemimit të arsyeshëm është diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara në fushën e punësimit. Kriteri i përgjithshëm i punësimit “gjendja e përgjithshme shëndetësore” mbetet të jetë e pakonkretizuar dhe aplikohet pa personalizim. Kjo gjë parashtron pengesa për qasje në vende pune në sektorin publik për personat me aftësi të kufizuara që nga vetë fillimi. Gjithashtu, lista e aftësive të kufizuara lidhur me atë që konsiderohet të jetë



Pas aksidentit në trafik, një person që kishte fituar aftësi të kufizuara, kishte marrë ndihmë financiare. Ai është baba i tre fëmijëve, të gjithë studentë. Pasi kishte marrë mjete financiare në llogarinë e tij bankare me transferr nga banka në bankë, jo vetëm që ishte ndërprerë ndihma e tij, por ai ishte detyruar ta kthejë ndihmën financiare që kishte pranuar deri atëherë.

paaftësi në nivelin kombëtar mbetet e parishikuar, pavarësisht nga ratifikimi i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, qasja mjekësore në aftësi të kufizuara, si në ligj, ashtu dhe faktikisht akoma mbi-zotëron, me atë që disa forma i shmangen radarit në nivelin kombëtar.

Përveç një reklame publike për punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe një praktike të dështuar të udhëheqjes së kompanive për strehim, i gjithë përjashtimi i përfshirë i personave duket se është i pranishëm, dhe kështu, parandalon personat për të marrë një rol aktiv në jetën shoqërore. Kjo rezulton me përjashtimin e përgjithshëm dhe diskriminimin e personave në vend në të gjitha fushat.

Megjithatë, duhet shënuar se në tetor të vitit 2014, u prezantua për diskutime publike një skicë-ligj mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuara, i cili do ta zëvendësojë ligjin e vjetër.¹⁵ Ky ligj parasheh punësimin e detyrueshëm të personave me aftësi të kufizuara. Një nga të intervistuarit tanë rekomandon se “[D]uhet patur një ligj me të cilin në çdo 30 të punësuar, secila ndërmarrje do të punësojë një person me aftësi të kufizuara. Dhe nëse ata nuk respektojnë këtë, duhet të paguajnë gjoba.” Tani duhet të shihen rezultatet e diskutimeve publike nëse ky ligj do t’iu përshtatet si sektorit publik, ashtu dhe atij privat, ose vetëm sektorit publik dhe kompanive strehuese.

Paragjykimet në bazë të paraqitjes fizike gjithashtu janë shënuar në për-

15 Ky skicë-ligj ende nuk ka hyrë në procedurë parlamentare dhe për shkak të krizës aktuale politike, nuk është e mundur të parashohim nëse do të hyjë dhe/se nëse do të miratohet

vojat e përjetuara të të intervistuarve tanë, pasi paraqitja fizike paraqet një burim diskriminimi. Një nënë e vetme me fëmijë të vogël dhe një baba Rom dhe punonjës seksual – të dyve u është thënë se janë goxha mirë të veshur për të pranuar ndihmë nga shërbimet sociale. I akuzuar për bartjen e sëmundjes dhe “përpjekjet për t’i sëmurë të gjithë”, një person i pastrehë ishte dëbuar nga hapësirat e shërbimeve sociale. Ky person ishte pyetur nga punonjësi në shërbimin social “pse vjen çdo ditë, si “cigan”, vazhdimisht duke kërkuar diçka”.

Punonjësit në shërbimin social dukshëm janë tallur me një punonjëse seksuale me trans-gjini gjatë përpjekjeve të saja për të marrë ndihmë sociale. Njëjtë si personat më të varfër në ekzemplarin tonë, ashtu dhe ajo po ballafaqohet me keqtrajtim nga personat nga të cilët pritet të ofrojnë ndihmë. Veç kësaj, kur orvatet të denoncojë dhunë nga një klient ose dikush tjetër, policia e pyet atë “çfarë ke bërë për ta provokuarë atë” (Stasha). Një Rome tjetër ishte ankuar për mungesën e mbështetjes nga shteti në përpjekjen e saj për të marrë kujdestari për mbesën e saj, pas vdekjes së motrës së saj dhe për mungesën e mbështetjes si pasojë e përpjekjeve të saja për ta arsimuar atë dhe fëmijët tjerë të saj.

“Pse shteti nuk më ndihmon me kujdestarinë për mbesën time? Dhe me rritjen e saj? Të paktën me veshje... Nuk do ta lejoj që as ajo, as cilido nga fëmijët e mi të lypë. Fëmijët e mi shkojnë në shkollë.

Imazhi Nr.2 Strategjitë e përballimit të të intervistuarve



Shteti duhet parë këtë dhe duhet pranuar këtë [...] dhe duhet të më ndihmojë të krijoj kushte më të mira për fëmijët e mi. Por ata nuk bëjnë këtë.” Lutvija

Kjo që u cek më lartë qartë sugjeron se stafi që punon me grupet më të marginalizuara në shoqëri ka mungesë të arsimimit dhe ndjeshmërisë ndaj nevojave të tyre. Aq më tepër, në vend se të veprojnë në drejtim të ndihmimit të tyre në realizimin e të drejtave të tyre dhe pakësimin e brengave të tyre, dhe

në vend se t’u ofrojnë ndihmë për t’i plotësuar nevojat e tyre, personat që punojnë në institucionet shtetërore shpesh janë burimi më i fuqishëm i diskriminimit të të intervistuarve tanë.

Diskriminimi në bazë të moshës është poashtu i pranishëm për shumicën e personave, duke shënuar se personat e moshuar nuk janë në gjendje të punojnë, dhe në mënyrë të tërthortë në pretendimin e gjithëpranishëm se “të rinjtë nuk punësohen, e si presni që të moshuarit të punësohen?”.

"Shteti nuk duhet qenë këtu për t'u përmbaruar ju, por për të krijuar kushte për ekzistencën tuaj dhe për lulëzimin tuaj."

Stefani, baba i një fëmiju me aftësi të kufizuara

REKOMANDIMET PËR POLITIKËN

Në bazë të përvojave të tyre të përjetuara, nevojave të tyre elementare dhe strategjive të përballimit, të intervistuarit në këtë studim dhanë rekomandimet në vijim:

- Rritja e shumës së ndihmës sociale për të mundësuar një cilësi më të mirë të jetesës dhe për t'iu përshtatur më mirë shportës së konsumatorit;
- Bërja e procedurave më të lejueshme dhe që mrrin më pak kohë; shmangia e byrokracisë së panevojshme;
- Bërja e sistemit në përgjithësi më pak kufizues në kuptimin e kushteve për vazhdimin e dhënies së ndihmës sociale;
- Përmirësimi i qasshmërisë fizike dhe ndijmore për personat me aftësi të kufizuara dhe dhënia e sigurt e sistemit të arsyeshëm;
- Lejimi i kushteve për aktivizimin ekonomik formal të shfrytëzuesve të sistemit të mbrojtjes sociale dhe largimi i ndalesës së cilitdo aktivitet për fitim financiar për personat që pranojnë ndihmë të përhershme financiare;
- Përmirësimi i masave të punësimit për personat me aftësi të kufizuara;
- Ndërmarrja e masave për identifikimin e personave me nevojë për mbrojtje sociale dhe përcaktimi më i mirë i politikave dhe me këtë, dhe i ndihmës dhe masave;
- Përmirësimi i qasjes në zonat rurale, duke përfshirë këtu dhe dhënien e transportit publik falas për kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara;
- Bursa për fëmijët nga familjet e paprivileguara, inkurajimi i mësimin të përjetshëm dhe trajnimit profesional të personave në rrezik social dhe në nevojë sociale;
- Inkurajimi i pranimin më të madh social të personave me aftësi të kufizuara, i nënave të vetme, i mbijetuesve të dhunës familjare, i personave me trans-gjini, i punonjësve seksual, i personave të pastrehë;
- Fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve në shërbimet sociale për të punuar me grupe të ndryshme të personave të paprivileguar, posaçërisht me trajnime mbi ndjeshmërinë;
- Dhënia e shërbimeve plotësuese për prindërit e vetëm dhe kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara, siç janë shërbimet e kujdestarisë në shtëpi, qendrat ditore në nivelin lokal, shërbimet e shtuara ditore; dhe
- Ndihma në sigurimin e kushteve elementare të banimit, strehimet e personave të pastrehë, posaçërisht gjatë stinës së dimrit.